



2

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot _____
Dep. <u>D-P</u>	Bi. Prot _____
Nr. I faq _____	Prot No. <u>03-4467/11</u>
Str. stranica <u>01</u>	Date _____
Nr. pages _____	Datum <u>19.11.2011</u>



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 37302/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Batri Musmurati nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 lidhur me nenin 16 paragrafi 1 pika 2 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151,e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 11.11.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI : Batri Faik Musmurati, e lindur më 15.19.1947 ne fsh. Poliçk K. Kamenicë, tani më vendbanim në Prishtinë rr. Luigj Gurakuqi nr. 25, me profesion Zv. Ministre në Ministrinë e Pushtetit Lokal, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

I pandehuri në cilësinë e zëvendës ministrit në Ministrinë e Pushtetit Lokal , ku ka qen e obliguar qe në afatin ligjor , ta deklaroj pasurin mbas marrjes se funksionin në afatin prej 60 ditësh i cili nuk e ka deklaruar pasurin e vetë, të paraparë me ligj, të Agjensionit Kundër Korrupsionit.

Me këtë ka kryer veprë kundërvajtëse nga neni 7 lidhur me nenin **16 paragrafi 1 pika 2 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151**,andaj për këtë:

G J O B I T E T

Me gjobë në shumë prej 200(dyqind) Euro,të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që aktvendimi të merrë formën e prerë, në dobi të AFQ i drejtësisë në Prishtinë, në gjirrollogarin rrjedhëse 1000430070000518,nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 13 ditësh, duke ia llogaritur nga 15 Euro në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor është i obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.


A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit , parashtroi kërkesën nr.01-4104/11 të dt 24.10.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur.

Gjatë procedurës u degjua deklarata e te pandehurit i cili kundërvajtjen e pranoi, duke deklaruar se është e vërtet se unë nuk kam mbushur formularin për deklarimin pasurisë sipas keti Ligji ku dhe unë jam i obliguar qe ta plotësoj por arsyet kanë qenë pakujdesia e ime, ndaj deklarimit të pasurisë .

Gjyqtari pasi që administroj provat dhe të provuarit e kësaj çështje me të drejt konstatoj se pandehura ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë tërësi vërtetoi , andaj për këtë e shpalli fajtor dhe e dënoi si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit Gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoj këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngjashme. ,andaj u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.



VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë,në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjës së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksa.